



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 40 datë 27.7.2021

“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2021”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 27.7.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, i ndryshuar, të nenit 38,të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“,pika 4/a e VKM nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në suvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore ne treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në zonat urbane dhe ato rurale në territorin e Bashkisë Shkodër, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar në zonat urbane (lekë pa tvsh)	Çmimi mesatar në zonat rurale (lekë pa tvsh)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1	11,900	7,188
2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	1	17,700	10,938

3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	1	22,900	14,313
4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	1	32,000	20,625

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 2.8.2021